



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/B.r.str.	07
Data/Datum.	15. 01. 2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e parë – I, inauguruese (solemne), e mbajtur me datë 13.12.2017, ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezent në mbledhje ishin: Burim Berisha – Kryetar i Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arieta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Shaban Ademi, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Ariana Zogjani, Aida Alimi, Mehdi Lahu, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Driton Ademi, Betim Ahmeti, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Cirkovic.

Të tjerë: Nënkryetarët dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it, Policisë së Kosovës, përfaqësuesit e mediave dhe Zyrtari për Informim i Komunës.

Mbështetur në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale anëtarë më i vjetër i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në këtë rast z. Sabit Bullatovci, duhet ta udhëheq mbledhjen e parë inauguruese (solemne) për dhënien e Betimit dhe nënshkrimin e deklaratës solemne nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, formimin e Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe dhënien e betimit dhe nënshkrimin e Deklaratës Solemne nga Kryetari i Komunës.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Sabit Bullatovci: Kjo seancë solemne është ftuar nga Kryetari i komunës bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Të nderuar pjesëmarrës, anëtarë të porsazgjedhur të Kuvendit të Komunës, i nderuari z. Kryetar i Komunës, të nderuar zonja dhe zotërinj, përfaqësues të Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit Lokal, të OSBE-së, të KFOR-it, të Policisë së Kosovës dhe të gjithë të pranishmit në këtë sallë, po e bëj hapjen e mbledhjes së parë solemne inauguruese të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Ftoj sekretarinë që të bëjë verifikimin e prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe të verifikohet kuorumi.

Pas verifikimit se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes, theksoj se mbështetur në nenin 35, pika 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kërkohet që Kuvendi i Komunës të formoj Komisionin për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Mbështetur në këtë dispozitë ligjore ju propozoj që të përcaktoheni për kandidatët e Komisionit për verifikimin formal të mandateve, të cilat janë të certifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datën 29.11.2017, në përbërje prej tre anëtarëve, njëkohësisht kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të plotësojnë formularin për deklarimin e pasurisë dhe ta dorëzojnë në Agjencionin Antikorrupsion brenda afatit të caktuar.

Vjollca Konjusha: Përsëritës të pranishmit. Grupi Parlamentar i LDK-së për anëtarë të Komisionit për verifikimin e mandateve propozon znj. Arjeta Jashari.

Naser Graiçevci: Përsëritës të pranishmit në sallë. Për Komunën tonë sot është një ditë e madhe, breza të tërë kanë ëndërruar që ta kenë këtë ditë. Jemi krenar që jemi sot këtu dhe jemi krenar me këtë përbërje që do të jetë në shërbim të komunitetit, të qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës.

Ju uroj të gjithëve e sidomos anëtarët e rinj, urime dhe dëshiroj që të kemi një bashkëpunim shumë më të gjerë në këtë mandat qeverisës, në të mirë të interesave të qytetarëve të komunës. Për anëtarë të Komisionit propozojmë z. Migjen Kolshi.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në sallë. Për anëtare të komisionit ne propozojmë znj. Eglantina Azemi.

Kryesuesi i seancës, z. Sabit Bullatovci ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarohen për përbërjen e propozuar dhe të votojnë për formimin e komisionit për verifikimin e mandateve.

U votua unanimisht nga të pranishmit- gjithsej 27 anëtarë.

Komisioni bënë verifikimin e mandateve dhe më pas kthehet në sallë.

Arjeta Jashari: Përshëndetje për të gjithë. Komisioni për verifikimin e mandateve verifikoi listën e anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e datës 22.10.2017 dhe se më datën 29.11.2017 janë certifikuar rezultatet nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Komisioni konstatoi se janë plotësuar kushtet formale për realizimin e betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Ju uroj punë të mbarë të gjithëve!

Kryesuesi i mbledhjes, z. Sabit Bullatovci: Ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës për ta lexuar deklaratën e betimit dhe nënshkrimin e saj, konform konstatimit të Komisionit për verifikimin e mandateve, të formuar nga Kuvendi i Komunës.

Anëtari/ja që dhanë betimin dhe nënshkruan deklaratën solemne janë si vijon:

1. Vjollca Konjusha,
2. Remzi Shala,
3. Ilir Hasani,
4. Arieta Jashari,
5. Mirvete Gërguri,
6. Jetmir Berisha,
7. Albert Jasharaj,
8. Miranda Shabani,
9. Sabit Bullatovci,
10. Shaban Ademi,
11. Sabri Rexhepi,
12. Ali Zogjani,
13. Naser Graicevci,
14. Migjen Kolshi,
15. Ariana Zogjani,
16. Aida Alimi,
17. Mehdi Lahu,
18. Durim Hajra,
19. Eglantina Azemi,
20. Doruntina Jashari,
21. Driton Ademi,
22. Betim Ahmeti,
23. Ali Ismaili,
24. Driton Hasolli,
25. Qerim Gara,

26. Bashkim Krasniqi

27. Ljubisa Cirkovic.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Sabit Bullatovci: Ftoj Kryetarin e Komunës, z. Burim Berisha që të lexoj dhe të nënshkruaj deklaratën solemne të betimit.

Kryetari i Komunës, z. Burim Berisha, lexoi dhe nënshkroi Deklaratën Solemne të betimit.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Sabit Bullatovci: Përgëzoj Kryetarin, i uroj suksese dhe punë të mbarë edhe në këtë mandat katër vjeçar dhe e ftoj që të marr fjalën.

Kryetari i Komunës: Falënderoj Kryesuesin. Mbështetur në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale anëtar i më i vjetër i Kuvendit të Komunës e udhëheq mbledhjen e parë inauguruese. Ne e falënderojmë z. Sabit Bullatovci për mënyrën se si po e udhëheq këtë seancë solemne.

Të nderuar pjesëmarrës, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, KFOR-it, OSBE-së, Policisë së Kosovës, të nderuar punëtorë që punoni në institucionin tonë dhe institucionet tjera.

Është kënaqësi që kemi shansin për katër vjet të bëjmë më të mirën për qytetarët tanë, për këtë arsye edhe jemi votuar, që të gjithë së bashku të bëjmë komunën tonë më të zhvilluar, më të këndshme për të jetuar, dhe institucionet tona të jenë institucione ligjore dhe institucione kushtetuese. Kjo është detyra ime kryesore. Besimi që na u dha nga qytetarët për të qeverisur, kërkon nga të gjithë ne angazhim, punë, zbatim të ligjit, transparencë dhe përgjegjësi.

Ne të gjithë së bashku do të punojmë që të bëjmë një jetë të dinjitetshme, në paqe e harmoni me të gjithë, me pjesën e popullsisë shumicë e pakicë dhe me të gjitha partitë politike përfaqësuese në Kuvend, në të mirë të zhvillimit të mëtutjeshëm të komunës së Fushë-Kosovës.

Shpresoj se katër vitet e ardhshme do të jenë vite të mbara, me suksese, zhvillim ekonomik, shoqëror, politik, kulturor, social si dhe zhvillim demografik të tillë çfarë e kemi tani, i cili është i mirëseardhur për ne. Ne të gjithë së bashku po e çojmë këtë Komunë përpara dhe do të vazhdojmë punën për ta bërë njërën prej Komunave më të mira në Kosovë, ku njerëzit dëshirojnë të vijnë të jetojnë, ashtu siç janë duke ardhur tani dhe nuk ikin nga Komuna jonë.


Edhe njëherë urime për anëtarët e Kuvendit të Komunës, suksese dhe punë të mbarë, poashtu të gjithë të pranishmëve ju uroj festat e fundvitit, të cilat uroj të na sjellin shëndet, gëzim dhe lumturi në familjet tona!

Kryesuesi i mbledhjes, z. Sabit Bullatovci: Falënderoj Kryetarin e Komunës për fjalën përshëndetëse. Ju uroj festat e fundvitit të gjithëve dhe me kaq e shpall të mbyllur mbledhjen e sotme.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30 minuta.

Procesmbajtësi

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i mbledhjes

Sabit Bullatovci

